

INTERVISTË ME BAJRAM SHATRIN

Prishtinë | Data: 13 nëntor, 2024

Kohëzgjatja: 77 minuta

Të pranishëm:

- Bajram Shatri (I intervistuar)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Ana Morina (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zoti Bajram falemnderit që keni pranë me qenë pjesë e intervistës. Kisha dasht me kërku prej juve me na tregu diçka për veten e ju, për familjen, kohën kur jeni rritë ju si ka qenë? Si e kujtoni ju atë kohë?

Bajram Shatri: Unë jam Bajram Shatri, i lindur në fshatin Tomoc, Komuna Istogut me 28 qershor 1946. Shkollën fillore e kom kry në Gjyrakovc. Shkollën e kem pas afër aty ni killometër e gjys. Nuk ka qenë larg nga shtëpia. Por ka pas nxanës që kanë udhëtu ka pesë-gjashtë killometër, shtatë killometër kanë udhëtu në komë deri sa kanë ardh në shkollë. Kanë ardh për shembull prej Komunës Istogut, Komuna Pejës, kanë ardh nga Komuna Klinës, kanë ardh në Gjyrakovc. S'kanë pas shkollë fillore aty afër, shkollë të plotë tetë vjeçare. Klasën e parë e kom kry në Gjyrakovc te ni mësus i cili i ka pas vetëm katër klasë fillore të kryme.

Shumica e mësusve kanë qenë, jo shumica po të gjithë mësuesit në kohën time kanë qenë të pakualifikum. Mësusët e parë të kualifikum kanë fillu të vijnë në Istog dhe në krejt Kosovën, në vitin 1948-'49, kur e kanë kry Normalen në Gjakovë. Deri atëherë kanë qenë kursista. Vetëm ni shembull po e jepi, në vitin 1947 kanë qenë të punësum 421 mësus në Kosovë prej tyre të diplomum me shkollë të mesme, po thom kushtimisht në Normale të Shkupit, ka qenë në gjuhën turke e kanë kry Normalen në Shkup.

Kanë qenë 421 mësus prej tyne vetëm 34 kanë qenë të diplomum. Domethonë të gjithë të tjerët kanë qenë të pakualifikum. Kanë pas katër klasë fillmore, pesë klasë fillore me kursin e ulët, kursin e mesëm, kursin e lartë se në shkollë Normale nuk ka pas. Shkolla e parë Normale është çelë '46-tën deri '46-tën të gjithë mësusit e kualifikum janë kualifiku në shkollën Normale në Shkup ose eventualisht në shkollën Normale në Elbasan. Po numri tyre ka qenë shumë i vogël.

Unë kam pas fatin që mësusi im i parë të jetë mësus me katër klasë fillore edhe kuptohet sa ka qenë i pregaditur ai mësus për procesin mësimor. Ka qenë varfëri e madhe tekste kanë mungu totalisht, s'kem pas vend. Fletore kanë qenë disa, disa tabela kanë qenë janë shkru me kurshum [plumb] i thojshin ke shkru me ni laps, e ke fshi me ni shpuzë, shpuzë s'ka pas atëherë me ni harën [leckë] o fshi

ajo fletë. Dy anë kanë qenë, njona anë ka qenë katror matematik, njona anë ka qenë për shkrim me vija, me vija. Kështu që fletore nuk ka pas.

Ose ka ndodhë nëse mësusi nëse ka siguru fletore, fletoren e ka da përgjys. Gjysmën ja ka dhënë një nxanësit, gjysmën nxanësit tjetër. Fletoret edhe lapsat qashtu i ka da, lapsin e ka da përgjys e ka mprehë në dy anë lapsin edhe ju ka dhënë nxanësve, ka qenë varfëri e madhe, shumë e madhe. Nuk ka pas të pasur, kanë thonë në fshat nuk ka të pasur, po në fshat ka pas lopë e dele, po pare s'kanë pas edhe s'janë interesu për shkollë fare. Numri i vajzave në shkollë ka qenë shumë i vogël, sa më kujtohet mu s'kanë qenë tri katër vajza si kanë qenë në fillore.

Anita Susuri: A keni qenë shumë veta në klasë?

Bajram Shatri: Kem qenë, jo, kem qenë diku rreth 30 nxanës në vit të parë. Mandej numri tyne është zvogëlu domethonë ka ra. Se femrat për me i ndalu prej shkolle ju kanë ndërru datat ju kanë ndërru. Datëlindjen ju kanë ndërru qysh ju ka konvenu. Ka thonë, “Osht e re për shkollë” kur u shku ma vonë ka thonë, “Osht e vjetër për shkollë. I ka bo vjet osht feju”. Në atë kohë për shembull ka ndodhë vajzat kanë qenë të fejume para se me lindë. Ka qenë ushtar dy vit, dy persona kanë qenë ushtarë, gratë i kanë pas shtatzane i kanë lonë në fshat.

Ka thonë, “Nëse më lindë mu vajzë e ty djalë kena me u bo miq”. Domethonë i kanë feju. Po njonit prej tyne i ka lindë djalë, njonit vajzë edhe mandej ata kur janë rritë, janë martu. Kanë fëmi edhe sot, dytë kanë vdekë, i di personalisht i njoh. Domethonë janë feju para se me lind fare. Se me feju në shkollë fillore ka pas raste plotë. Ka ndodhë për shembull që i fejumi ka pas me shku në klasë me të fejumën edhe e ka ndërpre vajza kanë thonë, “S’bon me shku në shkollë se osht i fejumi atje”. Ka qenë kohë e errët, kohë e trishtë për kohën e sotme për shembull me krahasu ato fejesa që i kanë bo.

Anita Susuri: A keni qenë ju shumë fëmijë... të prindërve të juj po mendoj, që e keni viju krejt shkollën, që ka qenë ndoshta edhe për prindë e rondë pak?

Bajram Shatri: Kem qenë familje e madhe kem qenë në shkollë fillore, kem qenë. Në vitin 1961 jem nda si familje, migjallartë janë nda 42 anëtarë të familjes kemi qenë komplet. Kem pas fëmijë, kem pas pesë-gjashtë fëmijë, shtatë-tetë fëmijë si kanë çu në shkollë, kanë shku prej asaj familjes në shkollë. Rruga ka qenë afër, nuk ka qenë rrugë e largët po kushtet në shkollë kanë qenë shumë të fshtira, nxanësit kanë qenë të pa ushqym. Ni shoqatë sigurojke ushqim nxanësve qumësht, kesi qumësht pluhur që ka qenë, jepshin qumësht edhe ni copë bukë, kaqkavall a diçka japshin fëmijëve në shkollë në atë kohë ju ka dhënë, në të gjitha shkollat ju ka dhënë ushqim fëmive s'kanë qenë pa ushqim.

Anita Susuri: Naj organizatë e huj a?

Bajram Shatri: UNHRA ka qenë si Kryqi Kuq amerikan, amerikan kanë qenë. Më kujtohet ajo e ka siguru ushqimin fëmive. Po tani në klasë time ka ndodhë që nxanësi dimrit ka ardhë i zhveshur doemthonë s'ka pas këmishë, në tru të vetin s'ka pas këmishë. Nuk ak aps qerapa veç opanga, opangat kanë qenë të bome prej llastik përfuni edhe si...

Anita Susuri: Lëkurë diçka?

Bajram Shatri: Lëkurë, edhe lëkurën e maj në mend, lëkurën e kanë lidhë me pejë, e kanë lidhë me qëndru në komë. Domethonë si janë dal në oborr ajri i ftohtë edhe lagështia ka hi në komë meniherë. Mandej shkollën fillore e kom kry në Gjyrakovc. Dy klasë kanë qenë për shembull, 12-13 nxanës kem qenë me ni klasë se kanë qenë dy paralele, prej dy paraleleve u formu tani ni paralele në klasën e tetë. '61 - '62 e kom kry tani klasën e tetë.

[Këtu ndërprehet intervista]

Bajram Shatri: Tani shkollën e mesme në Istog u çelë, në vitin 1962 u çelë si paralele e ndame e Normales së Pejës osht çelë. Aty ka fillu për herë të parë shkolla e mesme në Komuën të Istogut se deri atëherë s'ka pas shkollë të mesme. Në shkollë të mesme une kam shku në Mitrovicë e kam kry gjimnazin. Se Normalja u çelë në Istog unë nuk dashta me shku në Normale, dashta me shku në gjimnaz. Kom shku në Mitrovicë, ka ndodh prej Mitrovice në Tomoc 52 kilometra i kom ecë në komë, disa herë kom shku në shpi në komë prej Mitrovice.

Anita Susuri: Për çdo ditë keni udhëtu, apo...?

Bajram Shatri: Jo kom banu në Mitrovicë. Ka ndodhë që për festa a diçka me shku, atëherë nuk kisha autobus. Ishte problem me gjetë biletën e autobusit, atëherë në stacion të autobusave edhe tre-katër shokë jemi bo edhe kemi udhëtu, në komë kemi shku në Tomoc 52 kilometra, si nxanës në shkollë të mesme.

Anita Susuri: E si ka ndryshu tash ëpr shembull në shkollë të mesme situata me libra, me kushte?

Bajram Shatri: Në shkollë të mesme dashta me tregu se shkollat e mesme në Kosovë janë themelu shumë vonë, edhe ato shkollat e para të mesme kanë qenë në gjuhën serbo-kroate, nuk ka pas gjuhë shqipe. Gjimnazi për shembull, gjimnazi i parë në Prishtinë osht çelë '46-tën në Prishtinë edhe maturantë e parë në Prishtinë kanë dal '49-tën deri atëherë s'ka pas nxanës fare në shkollë të mesme në gjuhën shqipe. Gjuhën shqipe në gjimnaz e kanë çelë në '50 - '51 Mitrovicë, në Pejë edhe në Prizren janë çelë qat vit, dej atëherë gjimnaz s'ka pas vetëm në gjuhën serbo-kroate. Në gjuhën serbo-kroate '45 janë çelë gjimnazet.

Atëherë edhe pse kemi qenë në shkollë shqipe '62-tën shumicën, shumicën jo po plot landë kem pas arsimtarë në gjuhën serbo-kroate. Ka ndodhë fiskullturë shpesh herë s'ka pas fiskullturë, BAT [Bazat e Arsimit Teknik], histori, gjeografi ka ndodhë muzikë ka dhonë sërbi. Do të thotë s'ka pas arsimtar të gjuhës shqipe fare. Tani kur u çelën Normalet, që thash Normalja e parë çelët '46-tën në Gjakovë e mandej shumë ma vonë në shkolla Normale tjera në Kosovë. Gjenerata e parë pesë vjeçare në Normale ka dalë në Prishtinë '58 - '59 deri atëherë të gjitha Normalet kanë qenë katër vjeçare ose kanë qenë si ka qenë në Gjakovë për dy vjet janë kry katër klasë Normale.

Tekste shkollore s'ka pas fare ose ka pas në gjuhën serbo-kroate. Ka qenë fshtirë me i kuptu ato nuk e dishim na gjuhën shqipe si duhet mirë, jo gjuhën serbo-kroate. Arsimtarët kanë qenë të pakualifikum. Në Mitrovicë gjimnazi ka qenë i fortë është sistemi krejt kuadri mësimor i rrethit Mitrovicë. Gjimnazi gjithmonë e ka pas kuadrin e mirë se sa shkollat tjera profesionale. Shkollat profesionale s'kanë pas kuadro, inzhinjerë për shembull, ekonomista, jurista. Prandaj janë çelë shumë vonë shkollat profesionale.

Anita Susuri: Si ka qenë për juve me jetu prej një vendi të vogël ma rural, në Mitrovicë se po më duket që Mitrovica ka përparuar pak ma shumë, se ka qenë qytet industrial?

Bajram Shatri: Po shiqo kushtet, atëherë gjimnazi nuk ka pas konvikt ke banu privat, kem banu në shpi private. Mungesa e ushqimit ka qenë totale. Une personalisht e kam marrë sëmundjen 'terri i syve', 'terri i pulave' mungesë vitaminave. Kom qenë në klasën e dytë në gjimnaz kur kom shku te doktori nuk shisha në mramje fare. Shkova te doktori tha, "Ti e ke sëmundjen 'terri i pulave'". Shkoj te kujdestari i klasës Skender Skenderi i thom, "Qishtu e kom sëmundjen më ka thonë 'terri i pulave'". "Me shku në shpi" tha, "Po s'jom pyet, do landë s'jam pyet". Tri java para se me u kry viti shkollor më ka thonë me shku te shpia, me u ushqy me ve, me qumësht edhe mi ka mbyllë notat para kohe. E kom shku në shpi, mas dy dite jom shëru. 'Terri i pulave' mungesë vitaminave, veç bukë thatë tjetër sen s'kishim çka me hongër.

Anita Susuri: S'paskom ndëgju kurrë 'terri i pulave' tash mo ndoshta nuk është.

Bajram Shatri: Jo, nuk është aktuale, mund të jetë në ndonjë familje skamnore. Ushqim i njëtrajtshëm. Kanë qenë, kushtet e fshtira kanë qenë shumë. Mungesa e konvikteve, prandaj tri vajza i kena pas në gjimnaz në klasë të parë, se kanë qenë tri paralele. Kur jam dalë në klasën e katër drejtimi shoqëror asni vajzë s'ka qenë, se e kanë ndërpre mësimin. Ato vajza që e kanë kry gjimnazin kanë qenë kryesisht të qytetit në Mitrovicë, të fshatrave nuk ka pas nxanës.

Anita Susuri: E po më intereson për jetën kulturore a keni qenë aktiv, a ka pas diçka që keni mujt me u kativizu?

Bajram Shatri: Jo, mor' çfart (qesh). Ky Teatri Krahinor jepte shfaqje nëpër qytete të Kosovës, të vetmin argëtim e kemi pas teatrit edhe filmat, naj film kur mujshim me shku najher kështu. Ndeshje futbollistike msheftë hishim në stadion diqysh, s'pagujshim biletë. Nuk ka pas jetë kulturore. Edhe pse ka pas, grupi i letrarëve ka qenë, kanë majt kohë pas kohë orë letrare në gjimnaz. E kemi pas kujdestar klase arsimtarin e gjuhës Latif Berishën, ni profesor shumë i njoftun shumë i dashur për nxanës, i aftë për mësimdhënje. Atëherë e kanë vra, në Mitrovicë e kanë vra, Latif Berisha profesor ka qenë në fakultet për shumë vjet. Edhe Fadil Gungën e kena pas profesor, ata organizojshin orë letrare. Fadil Gunga ka qenë poet, ka punu në televizion.

Anita Susuri: Ju pastaj e keni vazhdu edhe fakultetin pas përfundimit po si keni vendos edhe a ka qenë vështirë për familjen me ju përkrah? Apo vet keni punu?

Bajram Shatri: Jo unë kur e kom kry gjimnazin dy vjet kom punu si mësus në fshat Zallsh, në gjimnaz kam punu. Kam grumbullu pare sa kam mujt me grumbullu. Kom dhon mësim në shkollë Normale në Prizren. Se atëherë kush e kryjke gjimnazin ka pas mundësi mu kualifiku për Normale kanë shku Prizren, Mitrovicë, Prishtinë kanë organizu kurse për landë diferenciale, për ato që s'janë mësu në gjimnaz, landë profesionale. Edhe e kom dhonë provimin e Normales në Prizren, mandej mas dy vjete pune në Zallsh, ni fshat kam punu si mësus, kom ardh në fakultet.

Nxanësit kanë udhëtu, kanë qenë shumë të varfën se Zallsi ka qenë kështu lokalitet i varfën në përgjithësi. Thash, kom pas nxanës që në dimën ka ardh dathë. Mbathë pa kurgjo hiç, pa këmishë, pa xhamper veç ni këmishë, ni xhempër, ni setër, në vend të këmishë e xhempër e ka pas qat setër. Unë si ëmsus kom marr prej shpije ju kom çu këmishë e xhempër e opanga, atëherë opanga kemi ble. Kurrë se kam pa atë nxanës mo, jom i interesum me ditë ku osht, s'di ku jeton e si jeton.

Anita Susuri: Si ka përfundu.

Bajram Shatri: Si ka përfundu, veç varfni e madhe ka qenë, shumë e madhe, shumë. Në fakultet kur kom ardh në vitin '68 kam ardh ën fakultet.

Anita Susuri: '68-ta koha kur ka ra Rankoviqi po osht edhe koha demonstratave, a ju kujtohet kjo a keniq enë pjesëmarrës?

Bajram Shatri: Po si jo, kom qenë në demonstrate kom marr pjesë. Ni ditë përpara, ni java përpara e kem kuptu si do të bohën demonstrata e kem lonë me u taku mes Fakultetit Filozofik edhe shkencave natyrore. Osht nifar, nifar sheshi i vogël aty, aty e kemi lonë mu taku. Ka qenë ditë e mërkurë si sot më kujtohet kemi pas mësim në sociologji me Fehmi Aganin. Në ora katër kanë pas em u nisë demonstratat. I them, "Profesor sot osht i 28-ti, 27-ti në katun kena me shku a bon mos me majt orën?". Profesori e ka ditë që do të ketë demonstrata. Tha, "Urnoni shkoni tjetër ditë e majm këtë orë. Edhe jem dal në demonstrata, kur jem dal prej Fakultetit Filozofik jem nis deri te sheshi atje posht më ra. A

beson që s'kem qenë krejt 200 vet, kom thon krejt kanë me na hongër. Atëherë kur dolëm te sheshi tash si është...

Anita Susuri: Po, "Nënë Tereza" sheshi.

Bajram Shatri: Jo këtu në fillim.

Anita Susuri: A "Zahir Pajaziti"?

Bajram Shatri: Te katedralja qaty, përball. Kur dolëm aty atëhere erdhën Fakulteti Juridik edhe Ekonomik, u mush turma e studentëve. U mush se kur jem nisë as 200 vet s'kem qenë. Edhe tu dal atje poshtë, ni milic ka thonë, "Nalnu vllazën, nalnu vllazën" [çon dorën] edhe njoni i ra me pankartë, i ra në kokë atij milicit, i ra kapela poshtë, e ka nxjerrë alltinë ka gjujt allti edhe e lëshoj rrugën. Kem shku tani, kem lëviz herë dej te Kuvendi Kosovës herë dej te Fakulteti Filozofik qaty e kem pas marshimin, shkojshim edhe atje.

Atje dul ni kamionetë me i lag demonstrusët. E morën studentët atë cisternën e ujit e lagshin policinë. Ka qenë interesant. Tani ka në 12 natës, dolën te Fakulteti Filozofik na folën disa aktivista Smajl Bajra, disa të tjerë. Mark Krasniqi e këta. Edhe e lam nesër ni grup i studentëve diku prej dhetë vetëve me shku nesër në Kuvend të Kosovës edhe me tregu ça po kërkojmë kështu. Edhe u shpërndam ka në 12 natës jemi shpërnda, dikun afërsisht ka në 12 natës.

Nesrit kur jom çu, nesrit mëngjes, kanë qenë konviktet këtu te Fakulteti Filozofik, do baraka kanë qenë të ushtrisë. Aty afër barakave plot policë. Edhe puna e delegacionit me shku në Kuvend Kosovës ra se e kanë thirrë Mark Krasniqin. Marku ka thirrë në Kuvend ka thonë, "Kena me ardh në ora dhetë" ka thonë, "Del e kqyr në oborr nihere, del e kqyr në oborr sa policë jonë". Tani kur i ka pa gjithë ata policë ka ra ajo kërkesa se domethonë s'kanë leju me kontakti fare.

Anita Susuri: E di që pastaj ka pas edhe do arrestime, a ka qenë dikush prej shokëve të juj?

Bajram Shatri: Isa Kastrati ka qenë, kojshi e kemi pas, këtu e kam kojshi Isa Kastratin, jam njoft me to. Përveq Isa Kastratit tjerët si kom njoftë aktivistat si kom njoft. Ata kanë punu shumë në organizmin e demonstratave. Që demonstratat kanë qenë më të dinjitetëshme në Jugosllavi se ka pas demonstrata edhe në vende tjera në Jugosllavi para 28 Nëntorit. Këta kanë qenë aktivista jashtëzakonisht të devotshëm, kanë shkru libra mandej, kanë shkru libra për demonstrata.

Anita Susuri: Ju fakultetin pastaj e keni vazhdu edhe keni diplomu po më duket pastaj keni punu në shkollën "Emin Duraku"?

Bajram Shatri: Jo, në Mitrovicë kom punu në shkollë Normale, në shkollë Ekonomike, në shkollë të mjekësisë kom dhonë mësim veç vendin e punës e kam pas në Ekonomi edhe në shkollë Normale se kanë qenë të bashkume ato. '73-tën kom shku në Normale në Mitrovicë, '74 në të vërtetë deri '78-tën. '78-tën kom ardh në "Emin Durak" si pedagog. Jam ndër pedagogët e parë të Komunës së Prishtinës. Si pedagog shkova në "Emin Durak" para meje s'ka pas pedagog.

Ka qenë pune e dobishme por punë e mundimshme sepse se kanë kuptu punën e pedagogut atëherë e as sot se kuptojnë rolin e pedagogut. Ni shkrim që e kam bo '72-tën, '73-tën, '78-tën, '79-tën e kam bo ni shkrim për rolin e pedagogut dhe vështirësitë që i ka pedagogu e këta në Institut Pedagogjik e kanë marr atë punim e kanë lexu. Thotë, "Qajo që e ke thonë ti para sa vjet, qajo osht aktuale edhe sot. Se pedagogun e lypin me qenë edhe administrator {numëron në gishta}, me qenë edhe kujdestar. Me qenë edhe zavendësues i mësusit, me qenë edhe me i punu statistikat. Domethonë lypin punë të cilat nuk janë të pedagogut.

Pedagogu ka punë instruktive pedagogjike edhe punë këshilluese me nxanës, me nxanës edhe arsimtarë. Tani si pedagog kam punu me radio Prishtinën e kom pas ni emision "Pedagogu ju përgjigjet". Nja dy vjet e kom udhëheqë një emision në radio Prishtinë niherë në javët në radio Prishtinë. Ka qenë interesant atëherë këshillat e para pedagogjike se dej atëherë s'ka pas këshilla në radio-televizionet. Pastaj shtatë vjet kam punu pedagog në "Emin Durak". Mandej kam kalu në Bashkësi të Arsimit, Bashkësi Krahinore të Arsimit ku sekretar ka qenë Ejup Hamiti, profesor-doktor Ejup Hamiti unë kam shku si këshilltar për plan dhe analizë.

Mandej jam bo koordinator, koordinator ka qenë një lloj drejtori për administratë. Aty jam marr me punë profesionale me plan dhe analizë kom bo plane të regjistrimit nxanës, studentë dhe nxanësve të shkollës mesme, kriteret për regjistrimin e nxanësve në shkollë të mesme. Mandej planet e regjistrimit të nxanësve të shkollave të mesme. Si i miratojke kuvendi i bashkësisë së arsimit edhe aty naj kuvend ka qenë përgjegjës për planet e zhvillimit të shkollave të mesme dhe shkollave fillore dhe fakulteti. Aty kom pa që ka pas dallime të mëdha të plani i regjistrimit të nxënësve të shkollave të mesme, për shembull në një shkollë në Skenderaj ka pas krejt pak nxanës në shkollë në gjuhën serbo-kroate.

Bile edhe serbëve ju kom dhonë mësim në gjimnaz në Skenderaj ni vjet, psikologji ju kom dhonë, pesë-gjashtë nxanës kanë qenë krejt. Edhe kur u bo plani i regjistrimit të nxënësve në shkollë të mesme sa janë planifiku me u regjistru nxanës shqiptarë në gjimnaz aq janë planifiku edhe serbë në Skenderaj, edhe pse nuk ka pasë nxanës. Po duhet me planifiku me i rezervu vendet edhe për nxanës të ardhur prej jashtë Kosove.

Ka pas raste që kanë ardh prej jashtë Kosove në shkolla të mesme sidomos në shkolla të mesme kanë ardh edhe nga Maqedonia. Në Kaçanik për shembull kanë ardh plot nxanës s'kanë mujt me u regjistru në Shkup s'ka pas shqip, kanë ardh në Kaçanik janë regjistru edhe financimin e ka bo Bashkësia

Krahinore e Vetfinancimit, për nxënësit shqiptar të komunave jashtë Kosove Presheva, Medvegja, Bujanovci. Plot kanë kry shkolla të mesme këtu në Kosovë.

Anita Susuri: A keni qenë ju mësimdhënës në kohën kur kanë ndodh demonstratat apo keni qenë...

Bajram Shatri: Student.

Anita Susuri: Jo, jo '81-tën, më falni.

Bajram Shatri: Pedagog në shkollë kam qenë në të vërtetë, pedagog shkolle në "Emin Durak" kam qenë.

Anita Susuri: Si i keni përjetu këto ju?

Bajram Shatri: Po ishte problem se nxansit edhe në shkollë fillore dilshin në demonstrata. Domethonë u dasht me dal, para nxanësve kom shku, bile më kujtohet njëherë shtafeta e Titos pat ardh në Prishtinë e manifestimi u zhvillu në sheshin përball teatrit, unë nxansëve ju kom pri prej "Emin Durakut" se ish kohë e demonstratave ju prijsha nxanësve gjoja për manifestim të Titos për shtafet a kërkush nuk u nal te shtafeta fare e vazhdoj rrugën deri te "Grandi" në shejë proteste edhe nxansit në fillore kanë protestu kur ishte problem se vishin policia i përcillshin, i përcillshin çka po shkrujnë nxansit.

Për shembull, "Kosova Republik RK" nëpër banka, nëpër fletore nëpër ato. Bile ni rast ni SUP-ovc [punëtor i Ministrisë së Brendshme] i thotë drejtorit, ni Sylejman Salihu ka qenë drejtor shumë i zoti, shumë i gjindshëm. Tha, "Shok drejtor nxansit e tu kanë shkru në vc Kosova Republikë" e tha, ky drejtori tha, "Çka po të ha dreqi me shku në vc çka po lyp ti aty? Me shku me kqyr çka" (qeshë), "me kqyr nxansit çka po veshin, qysh po veshin, me kon po shoqnohen". Ka edhe nxanës në fillore që kanë marr.

Anita Susuri: A e kanë maltretu naj nxanës të jujin?

Bajram Shatri: Jo në "Emin Durak" nuk kanë maltretu po ka pas raste që i kan maltretu në Kosovë, ka pas raste plot. Ka pas raste që i kanë përjashtu prej shkolle, i kom shkru edhe në libra të mia i kom shkru masat që i kanë ndërmerr ndaj nxanësve, ndaj mësimdhënësve. Osht ni rast për shembull '81-tën ni rast në shkollë ka shku policia e ka gjet tu kqyr ndeshjen futbolistike në televizor, se bojshin kujdestari atëhere në shkollë mësimdhënësi u dufke me nejt gjithë natën kujdestar me rujt, prej kujt me rujt nuk di veç u dufke me nejt në shkollë. E kanë gjet tu kqyr ni ndeshje sportive Shipëria tu lujt ni ndeshje, atje në Dukagjin e ka kap televizionin Tiranës, ka pas qasje në televizion. Edhe i thojnë, "Pse e ke lëshu?" "E kom lëshu me pa ndeshjen". Edhe bone me men atë arsimtar e kanë përjashtu prej pune veç pse ka kqyr televizion shqiptar, '81-tën.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Si ka vazhdu pastaj puna, më tregut që e keni lonë pastaj shkollën, mësimdhënien, deri cilin vit keni punu?

Bajram Shatri: Në Bashkësi të Arsimit kom punu deri në vitet '90-ta, '90-tën na kanë përjashtue. Na kanë përjashtu prej pune. Në nëntor, me 10 nëntor na kanë përjashtu. Mu më kanë përjashtu posaçërisht se kom refuzu të jem inspektor i arsimit për shkollat e mesme. Për shkollat e mesme i kanë caktu 20 inspektor që kanë ardh nga Sërbia në Kosovë. Ministri i arsimit Domangjiqi i ka thirr inspektor ndihmë prej Sërbie edhe tre nga Kosova. Në mesin e treve më kanë caktu edhe mu si inspektor meqë prej bashkësisë i kom udhëheq edhe shkollat e mesme.

Edhe unë i thash atina sekretarit serb i dhunshëm që ishte, thash, “Unë nuk jam inspektor, nuk di me i inspektu shkollat”. Tha, “Edhe këta që janë ardh prej Sërbie nuk jan inspektor po e kryjnë punën e inspektorit”. “Une” thash, “nuk muj me kry”, tha, “ki me pas pasoja” thash, “jam i vetëdijshëm për pasojat”. Se qëllimi i inspektorit ishte me shku dy serbë në shkollë edhe ni shiptar mandej me marr vendim me thonë, “Kjo shkollë si plotëson kushtet për funksionim me i mbyll shkollat”. Do të thotë roli i inspektorit ishte me i mbyll shkollat shqipe edhe aty nuk shkova.

I kan mbyll shkollat Serbia në vitin '90-të i ka mbyll shkollat shqipe me pretekst se nuk ka kuadër mësimor, nuk ka kushte për punë. Diku 20 paralele të ndame i kan mbyll atë vit. Osht interesant me përmend se në këto shkolla arsimtarët kanë shprehë dëshirë të punojnë edhe pa pagesë vetëm të funksionojnë shkollat. Nxansit serbë kanë punu paradite, ndërrimin ma të mirë. Nxansit shqiptar kanë punu masdite. Gjoja se janë të rrezikum nxansit serbë me punu masdite se prej shqiptarëve... nuk ka dritë i sulmojnë shiptarët nxansit edhe mësimdhënësit.

Kështu që, i kanë nda nxansët simas gjuhëve, paradite serbë, masdite shqiptarë. Edhe njejtën kohë e ka nda edhe shkollën për shembull në Prishtinë kanë thonë shkolla e mesme e mjekësisë me qenë për shqiptarë, gjimnazi për shqiptarë, shkollat tjera... Në të vërtetë, më fal për serbë, se shkollat ma të mira i kanë zgedh për nxanës serbë, për shiptarë ka met kusuri, çka s'kanë mujt me plotësue me nxanës serbë.

Numri i nxanësve deri në vitin '90-të në të vërtetë arsimit shqip periudhat ma të ndritshme i ka përjetu në vitet '74 deri në '80, prej '81 deri '90 numri i nxanësve ka fillu me ra për shkak dhunës dhe presionit që kanë pas ndaj nxanësve shqiptarë. '90-tën për shembull shqiptarë në shkolla fillore kanë qenë 305 mijë nxanës shqiptarë. Në gjuhën serbe kanë qenë 42 mijë serbë e në gjuhën serbe kanë qenë dikun 1 mijë e 800 nxanës në gjuhën turke. Në vitet '90-ta ky numër i nxanësve prej 305 mijëve ka ra dikun 263 mijë, diku 40 mijë nxanës në vitet '90-të ka ra numri i nxanësve në shkollë, shkollat fillore.

Edhe në shkollat e mesme ka ra numri i nxanësve dukshëm ka ra prej 71 mijëve ka ra dikun 63 mijë. Struktura arsimtarëve u dobësu për shkak se ni numër i tyne ka dal jashtë në shtete evropiane, diku unë i kam do shënime prej vitit '90 deri '92 kanë dal diku 2 mijë mësimdhënës e kanë lëshu Kosovën. Edhe numri i nxanësve u zvogëlu për shkak se në vitet '89 - '90 i kanë lyp me shku ushtar këta për me ikë prej ushtrie janë dal jashtë.

[Këtu ndërprehet intervista]

Anita Susuri: '91-tën pastaj...

Bajram Shatri: '90-tën janë apliku masat e dhunshme nëpër shkolla, në të gjitha shkollat fillore, shkollat e mesme dhe në fakultet '91-tën janë apliku masat e dhunshme me arsyetim se janë të diskriminim nxansët, mësimdhënësit serbë. Kanë lyp me qenë drejtori serb, zëvendës drejtori me qenë shiptar edhe eventualisht turk. Masat e dhunshme kanë qenë vendimet i ka lëshu Domangjiri, ministër i dhunshëm i arsimit. Në vitet e '90-ta osht punu me plane dhe programe të Kosovës për herë të parë pleqësia e arsimit e kena miratu ato programet e hartuara nga Enti Pedagogjik i Kosovës.

Edhe osht punu me klasën e parë fillore, me klasën e pestë të shkollës fillore edhe klasën e parë shkollë të mesme, tri klasë domethonë që aplikimi i planeve të reja të shkon në mënyrë suksesive, për çdo vjet duhet ni klasë me u shtu, në vitin '91 u dasht mu shtu klasa e dytë, e gjashta edhe e dyta në shkollë të mesme kështu në mënyrë suksesive. Në vitin '90 - '91 për herë të parë aplikohen plan-programet e hartuara nga shqiptarët deri atëherë kanë qenë planet dhe programet e hartuara nga serbët edhe tekstet shkollore poashtu kanë qenë të hartuara nga serbët.

Veç ni rast besoj që osht interesant, në vitet '50-ta 12 tekste për shkolla fillore klasa e parë dej klasën e katër janë shkru nga autorët serbë, sintaksa, gjuha shqipe u shkru nga autorët serbë, ndërsa është përkthi nga autorët Tahir Latifi, Enver Gjergjeku, Mehmet Zhavori janë përkthi tekstet në gjuhën shqipe. Merre me mend sintaksa në gjuhën shqipe osht shkru nga serbi u dasht me u përkthi në gjuhën shqipe, me u përshtat në gjuhën shqipe. Tekstet e matematikës mo s'ka pas nevoj me u përshtat fare janë përkthi bukvalisht janë përkthi.

12 tekste, për shembull një tekst më kujtohet sintaksa në klasë dytë fillore Juri Kemf, leximin e dytë në fillore Juri Kemf e ka shkru e ka përkthi Mehmet Zhavori, e kanë përshtat për nxanës shqiptarë. Se s'kanë leju. Abetaren e parë që e kanë shkru ma së parie e kanë shkru në gjuhën shqipe për me i çu në Beograd u dasht me i përkthi në gjuhën serbo-kroate për me marr lejen. Tani prej gjuhës serbo-kroate me përkthi prapë në gjuhën shqipe për me përdor tekst shkollor.

Krejt tekstet kanë qenë të shkru me nga autorët serbë, kjo osht fjala për vitet '50-ta, '60-ta. Vetëm '71-tën teksti historisë, '67-tën në të vërtetë teksti i historisë osht shkrujt në gjuhën shqipe nga Ali

Hadri edhe ai tekst plotësues ka qenë se tekstet e historisë kanë qenë të shkruara nga autorët serbë. Veç ky ka qenë tekst i përgjithshëm për tri klasë. Pjesë shtesë për klasën e pestë, gjashtë, shtatë, teksti i Ali Hadrit përndryshe këto kanë qenë të shkruara prej serbëve.

[Këtu ndërprehet intervista]

Bajram Shatri: Në vitin 1990-tën masi u aplikun masat e dhunshme u ndërpre edhe financimi i arsimit. Prej shtatorit u ndërpre financimi për mësuesit e klasës së parë, arsimtarët e klasës pestë dhe mësime të tjerë, profesorët e klasës parë shkollës mesme. Domethonë aty ku janë zbatu planet e reja, aty u ndërpre financimi. Ndërsa prej 1 janarit u bë ndërprerje totale e financimit të arsimit të mesëm ndërsa prej 1 prillit edhe shkollat fillore janë ndërpre, financimi. Domethonë mësime të tjerë e klasës parë, klasës pestë dhe klasës gjashtë kanë met pa të ardhuna prej shtatorit të viteve '90-ta.

Edhe ato janë solidarizim mësuesit, mësime të tjerë e tjerë me këta që s'kanë marr të ardhuna edhe i kanë nda në mënyrë lineare parat. Për shembull i kanë grumbullu parat i kanë nda për këta që s'kanë marr parat sikur me marr rrogën, i kanë marr prej kolegëve. Ndërsa prej 1 janarit, prej shtatorit u ndërpre shkollat në Istog u ndërpre krejt, bukalisht të gjitha shkollat. Prej shtatorit domethonë '90-tën, në Podujevë, në Lipjan edhe në Obiliq, katër komuna janë ndërpre prej shtatorit u ndërpre financimi i tyre.

Ata kanë met pa të ardhuna, të ardhurat i kanë siguruar prindërit ku kanë mujt me i siguruar të ardhurat ose kanë punu pa parat. Pa parat kanë punu mësime të tjerë prej vitit, të gjithë mësime të tjerë kanë punu prej 1 janarit '91 deri me 1 prill '92-tën kur për herë të parë fillojnë të financohen nga Këshilli Qendror i Financimit të Kosovës. Në vitet '90-të, '91-tën nxënësit nuk i kanë marr dëftesat e vulosne sepse drejtorët e dhunshëm si kanë lëshu, si kanë vulos, si kanë dhënë vulën shqiptarëve, kanë metë pa vula edhe meqë kanë met pa vula në shkollë të mesme të gjitha dëftesat janë lëshu vetëm me nënshkrim të kujdestarit të klasës dhe drejtorit shqiptar.

Se janë emnu drejtorët shqiptarë '91-tën. Pastaj për regjistrim të vitit '91 - '92, mbetëm me dëftesë të nënshkrime pa vulë, pa vulë janë regjistru në shkollat të mesme. Edhe aty tani u dasht me i marr kopjet e ditarëve, janë çu nëpër shkollat të mesme kopjet ku kanë dyshu edhe i kanë krahasu a janë të sakta. Prej kësaj kohe është e pakapshme, duket absurde qysh ka ndodhë po qashtu ka ndodhë. Në fakultet për shembull. Në shkollat të mesme i kanë lëshu dëftesat qashtu pa vulosne, mandej na e kemi marr në grup në ministri të arsimit, aktivistat që kanë punu në LASH në emën të ministrit i kemi marr ato dëftesa i kemi shumëzuar.

Kanë qenë 18 shkollat të larta, fakultete, 18 kopje secilës dëftesë, secilës listë, dëftesat i kemi dorëzuar për me i krahasu ata ku kanë shku me dëftesë e ka pas listën e atyre që e kanë kry shkollën e mesme, i kanë krahasu. Edhe asni rast s'ka ndodhë të keqpërdoret, të bëhet fallc për regjistrim në fakultet. Në fakultet kam qenë edhe senator, në universitet kam qenë shtatë vjet edhe atje e kom ëprcjellë gjendjen

edhe raportet që i kanë dorëzuar në fakultet i kam ruajt edhe i kom përdor mandej për shkrimet e mia. Edhe ata janë lavdëruar për mënyrën e organizimit për provimin pranë në fakultete me dëftesa të pavulosne.

Pastaj në vitet e '90-ta, '91-tën, '92 u ndërpre procesi. Janë majt protesta, s'ka fillu viti shkollor '91 - '92 edhe pse nxansit janë shkuar në shkollat fillore e shkollat të mesme e kanë mbyllur derën ma shumë ka pas policë se sa arsimtarë nëpër shkollat. Në vend drejtorave shumë herë e kanë dhënë përgjigjen milicët. Serbët kanë thënë, "Pa plan-programë nuk hini në mësim". E dini edhe ju e tonë e dinë prej shtatorit e deri 20 janar s'ka punë asni shkollë në Kosovë edhe pse gjatë kësaj periudhe janë majt demonstrata, protesta të ndryshme janë majt, po ato s'kanë dhënë kurrfarë rezultati.

Ka pas dilema a me majt me vazhdu mësimin a me ndërpre totalisht. Ka pas variante se nëse ndërprehet viti shkollor edhe qat vit shkollor nuk do të ketë mësim vitin tjetër do të aktualizohet kjo, bëhet çështje e madhe ndërkombëtare e mandej do të ndikoj që të hapen shkollat në gjuhën shqipe në objekte shkollore të hapen. Mirëpo mendimet ishin shumica e pjesëmarrësve në këto debate ishin që të vazhdohet viti shkollor, mos të hup viti shkollor sepse vitin tjetër shkollor do të bëhen dy gjenerata në klasë të parë fillore, do të dyfishohet do të bëhet çështje e pamundshme e organizimit të mësimin.

Edhe me 17 janar mas gjithë këtyne debateve tjera që kanë bo partitë politike, sindikatat, shoqata e arsimtarëve kanë bo debate të ndryshme çka me bo, osht marr vendimi në Ministri të Arsimit Muhamet Bici ka prur vendim me 17 janar që viti shkollor të filloj. Gjatë kësaj kohe kanë qenë të informuara shkollat se do të filloj viti shkollor në janar. Kanë bo kërkesa për shtëpi-shkollat, janë lëshu shtëpitë prej prindërve, janë paraqit diku 12 mijë kryefamiljar me i liru shtëpitë-shkollat. Po kryesisht në periferi qyteteve jo në qytet. Nuk ka pas në qytet se janë frigu.

Në vitin e parë shkollor ka fillu me 20 janar, ka pas shkollat fillore që kanë punë në shkollat private edhe shkollat e mesme, të gjitha shkollat e mesme kanë punë në shkollat private me përjashtim të katër shkollave, pesë shkollat kanë punë në objektin e tyre shkollor. Shkollat fillore kanë punë, në Ferizaj kanë punë në shkollat, në Fushë Kosovë tri shkollat, në Gjakovë, në Istog të gjitha shkollat fillore kanë punë në shtëpi private. Në Klinë ka punë në shkollë, në Lipjan dhetë shkollat. Në Obiliq, në Pejë ka gjashtë shkollat, në Podujevë dy, në Prishtinë tri shkollat.

"Faik Konica" ka punë në vitin e parë në shpi private, tani vitin e dytë janë sistemu në shkollat tjera fillore. Në Shtërpçë, Skenderaj edhe Viti, këto janë komunat që kanë punë me shtëpi shkollat, shkollat fillore. Shkollat e mesme kanë punë të gjitha në shpi private. Gjatë viteve të '90-ta shtëpitë e tyre i kanë lëshu 3 mijë e 200 kryefamiljar. Prej tyre prej një dhoma deri dhetë dhoma, krejt shpinë. Bile në Halim Mirnica i Vushtrisë, kanë qenë katër vllazën, katër shpija i kanë lëshu, 32 dhoma i kanë lëshu për shkollat të mesme të Vushtrisë.

Viti i parë ka qenë problem për organizimin e mësimit në shkolla fillore e shkolla të mesme sepse shkolla fillore klasa parë dej klasën e katërt ka qenë ma lehtë me i organizu mësime sepse ni mësues ka mujt me udhëheq klasën. Për klasë nate ka qenë problem sepse ni mësues u dasht me udhëtu prej ni shpije në shpinë tjetër, shpijat kanë qenë larg prej njona-tjetrës edhe atëherë kanë nis me majt mësimin bllok, për shembull për ni javë i kanë majt katër orë. Për shembull dy orë gjeografi i ka pas në javët i ka majt, historinë qashtut për ni ditë i ka kry për ni javë ditë për mos me udhëtu shumë prej shpisë në shpi.

Edhe ka pas problem se policia i ka ndjekë edhe në shpi private i ka ndjekë. Për shkolla të mesme ka qenë problem se mësimi ka qenë i organizum nëpër punkte. Edhe udhëtimi ka qenë i vështirë sepse komunikacioni ka qenë i vështirësuar. Autobusat ku ka pas popullat shqiptare s'kanë funksionu fare, kanë shku në komë, me bicikleta kanë udhëtu. Ka pas për shembull në Deçan, Istog, Klinë, nëse kanë qenë 60 paralele, 60 shtëpi-shkolla kanë qenë.

Organizimi i mësimit nëpër shtëpi private ka qenë shumë specifik, ka pas raste që në Pejë për shembull në punkte të Pejës që kanë punu nëpër fshatra ni ditë kanë majt mësime te ni prind e kanë bo simas alfabetit për 30 ditë, 30 kryefamiljar janë ndërru. Ni ditë kanë punu te ni prind, ni ditë te ni prindë i nxansit, ditë më ditë qashtu, 30 ditë - 30 kryefamiljar. Ka pas raste që kanë punu me javë për shembull, ni javë te ni prind, ni javë te prindi tjetër janë ndryshu.

Ka raste që kanë siguruar edhe ushqimin për arsimtarë në Klinë për shembull, në punktin e Klinës për nontë vjet sa kanë punu në shpi private, nontë vjet e kanë siguruar drekën për arsimtarë. Drekën e kanë siguruar nxansit simas renditjes në ditar qysh e kanë pas renditjen me radhë. Prindë ja kanë çu ushqimin arsimtarëve se s'kanë mujt me udhëtu. Kushtet kanë qenë të mjera, dhomat kanë qenë të vogla, janë nxe shpejt, janë ftoh shpejt, pa ndriçim, pa dysheme, sidomos vitin e aprë s'ka pas dysheme, s'ka pas...

Anita Susuri: Banka, sigurisht.

Bajram Shatri: Banka, karriga. Klasa fillore, e kam qit edhe në libër, klasa e parë fillmore të ulur në dysheme e tu mësu abetaren, shkrimet e para në dysheme. Në Fushë Kosovë për shembull katastrofë gjendja. Ato dhoma janë nxe shpejt, janë ftoh shpejt. Mandej ka ndodh u dasht me shku në dhomë prej korridorit me hi në kuzhinë, prej kuzhine në dhomë ku kanë mësu nxansit. E ka dhonë idenë Halim Hyseni për shtëpi-shkolla më kujtohet ni rast, ni gazetar i tha, "Po çka do me bo qaty zihet pasuli" po e banalizoj, "qaty zihet gjella, qaty mësojnë nxansët?" Thotë Halimi, "Tregom pra ti qysh me shku me mësu? Gjoma ti vendin ku nuk ka gjellë të shkojnë qaty nxansët".

Ka prindë që e kanë lëshu shtëpinë-shkollë për tetë vjet. Numri i tyre është jashtëzakonisht i madh si e kanë lëshu shpinë, për shembull do duhet mi veçu që janë shembull, osht ni Liridon Mëhalla në Varosh, Ferizaj; Skender Kaliçani në Istog; Haxhi Gjoci në Tomoc; Mehdi Dalloshi ky i vramë në burgun e

Dubravës, Kaçanik; Masar Kuka, Elez Han; Pashkë Përnokaj, Klinë; Hajredin Kryeziu Klinë. Nuk janë shumë po i numëroj. Dedë Domeniku në Pejë; Isuf Çelaj, Pejë; Ismet Poteraj, Podujevë; Sali Ahmeti, Podujevë; Gjergj Gjergji, Podujevë; Bahtir Talla, Podujevë; Ajfer Fetahu, Podujevë.

Mehmet Aliu, Prishtinë, ky e ka lëshu shtëpinë, përveq që e ka lëshu shtëpinë, ka siguru edhe ushqim për arsimtarë. Për festa ndryshme ka siguru miell, sheqer, vaj. Në fillim ka dhonë pare po këshilli e ka ndalu me dhonë pare, sepse nëse gjimnazi ka marr pare Shkolla Teknike s'ka mujt me marr pare, krijon pakënaqësi te ata mësime dhënë. Hajrullah Avdullahu në Prishtinë, shkolla e mjekësisë; Nijazi Gashi, Prishtinë; Isa Kastrati, Prishtinë, Isa Kastrati e ka lëshu shtëpinë edhe pse vet s'ka pas shtëpi si duhet, e ka lëshu. Shkolla e mjekësisë ka qenë në shpi të tij.

Zenel Cakolli, Prishtinë; Fadil Govori në Prishtinë; vëllezërit Zhushi në Prishtinë, këtu ka punu shkolla e mesme teknike edhe fakulteti ekonomik ka punu aty. Ibrahim Gashi, Prishtinë; Hamdi dhe Sefedin Aliu në Prishtinë; Hazer Kryeziu në Prizren; Qamil Morina në Prizren, Shqair Gashi, Prizren; vllazrit Mërnica në Vushtrri. Këta janë që i kanë lëshu shtëpia, mos em hi në gjyna edhe me tjerë që kanë lëshu shtëpia, shumë kanë lëshu, po këta i kanë lëshu ma tepër se pesë dhoma i kanë lëshu.

[Këtu ndërprehet intervista]

Bajram Shatri: Edhe fakultetet kanë punu në shtëpi private, fakulteti ka qenë ma specifik. Ni numër i arsimtarëve ligjeratat i kanë mbajtur nëpër shtëpitë e veta. Për shembull muzikë, art, i kanë mbajtur në shtëpi të veta. Ndërsa pjesa tjetër ka qenë e koncentruar në punkte. Numri i atyre që poashtu kanë lëshu shtëpi është i madh. Ndër ta duhet të veçojmë Fakulteti Filozofik ka punu në shtëpi të Sami Pejës, profesor i njoftun. Adem Krasniqi në Kodër Dillit. Ibush Mujaj, Ramadan Idrizi, pronar i “Rezonancës”. Ilaz Krasniqi, e tjerë.

Ndërsa ni kontribut të madh në mbijetesën e arsimit shqip gjatë viteve '90-të e ka dhonë edhe Bashkësia Fetare, Bashkësia Islame. Për shembull në shkollën e mesme “Alaudin” shumë shkolla edukatën fizike e kanë organizu aty sidomos fakulteti i edukatës fizike, krejt ushtrimet i ka mbajtur në atë fakultet. Tubimet e ndryshme të arsimtarëve, rektoratet, rektoratet e partive politike i kanë mbajtur në shkollën e mesme “Alaudin”. Ni rast, Ejup Statovci e ka marr kur është miratu ligji për universitet, ligji ri që e ka miratu senati, kam qenë prezent.

Ejup Statovcin edhe Destan Halimin e kanë marr policia. I kanë marr i kanë mbajtur ni muj ditë në burg i kanë mbajtur. Domethonë ato xhamitë i kanë lëshu. Xhamitë i kanë lëshu për shtëpitë-shkolla në Dragash, Ferizaj, Gjakovë, teqet i kanë lëshu. Në Obiliq, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Rahovec, Viti. Në këto komuna kanë punu, përveq në shtëpi private kanë punu edhe në xhami. Në Gjakovë teqet edhe xhamitë kanë punu tërë kohën nxënësit e shkollës mesme të Gjakovës.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Ju keni punu si Sekretar i Këshillit Qendror për Financim...

Bajram Shatri: Për Vetfinancim nihere...

Anita Susuri: Po. Ndoshta kishit mujt për këto me na fol?

Bajram Shatri: Po, pikërisht qato dashta. Meqë punëtorët e arsimit metën pa të ardhura personale që thash prej shtatorit '90 deri në prill 1991, ndërkohë ni grup i punëtorëve të arsimit dhe përkrahësve të arsimit janë angazhu me organizu nifar mekanizëm për me siguru të ardhura personale punëtorëve të arsimit. Në fillim i formu Këshilli Qendror për Vetëfinancim. I kishte nontë antarë Këshilli Qendror me këshilla komunal, i cili veproi gjahstë muj ditë. Për gjashtë muj ditë nuk mujt me siguru të ardhura personale përveç të ndihmave të herë pas hershme të komunave, shkollave po jo në mënyrë të përgjithshme financimin e mësimdhënësve edhe atëhere kryetar i këshillit për vetëfinancim ka qenë Adem Nimani profesor Adem Nimani.

Sekretar kam qenë une edhe atëherë u vendos që me 7 shkurt të vitit 1992 u formu Këshilli Qendror i Financimit të Kosovës që përbëhet prej shtatë anëtarëve, përfaqësuesit e partive politike, sindikatat. Edhe kryetar i këshillit u emëru Mehmet Hajrizi, Ali Gagica, Ismail Kastrati, Mustafë Blakaj, Naser Omsnai, Shyqeri Obertinca, Destan Halimi, Muharrem Ibrahimimi edhe une si sekretar i këshillit. Detyra jonë ishte që të mobilizohemi të sigurojmë të ardhura personale për të gjithë punëtorët e arsimit pa diferencim. Se Këshilli për Vetfinancim pat ndihmu Malishevën, Skenderajin, disa komuna që ishin ma të varfëra se s'kishin mujt me siguru komunat kurrfar të ardhura se ata të ardhurat i sigurojshin prindtë për secilën shkollë i sigurojshin prindtë.

Po kish dallime të mëdha se ni shkollë e cila kishte qendër ma të zhvillume, kishin mundësi me siguru të ardhura ma të nalta, ndërsa vendet e varfëra nuk kishin mundësi me siguru as të ardhura personale minimale. Atëherë u forum këshillat komunale të financimit prej shtatë anëtarëve u formun 32 këshilla. Edhe filloi grumbullimi i mjeteve ato dokumentacioni zyrtar. Kriteret e grumbullimit të mjeteve financiare u caktun për shembull për familje sa me pagu këtu mrena në Kosovë edhe në diasporë. Disa punëtorë që ishin që kryefamiljarët i kishin jashtë edhe ata kishin ni shtesë ma tepër. Këta kanë pagu dyfish, kanë pagu edhe në perëndim edhe këtu kanë pagu tatim.

Kështu që të ardhurat e para për financim u sigurun me 1 prill të vitit 1992. Të ardhurat e para për krejt punëtorët e arsimit kanë qenë 20 marka. Mirëpo, 20 marka s'kanë mujt me i siguru të gjitha komunat, të gjitha shkollat ka ndodhë që i kanë marr vetëm tetë marka. Se Këshilli Qendror i ka participu me mjete plotësuese financiare. Po ato në disa komuna s'kanë mujt fare me u grumbullu, kështu që s'kanë mujt me i siguru 20 marka i kanë siguru tetë marka. Shkrimet i kom publiku në libra të mia i kom faksimil sa i kanë marr.

Kështu që, Këshilli për Financim i ka siguru të ardhurat personale, i ka siguru për tetë vjet, në vitin e parë meniherë mas dy-tre muj ditësh u siguru prej 20 marka u bo 40 marka. Mesatarja e pagave '92 ka qenë 35 euro, '93-tën ka qenë '44 marka. '94-tën 70 marka, '95-tën 140 marka, '96-tën 151 mark. '97-tën 165 marka, '98-tën 198 marka. Këto ishin për shkolla të mesme. Shkollat fillore maksimumi '98-tën i kanë marr 150 marka. Në film nuk ka pas kriter, të gjithë punëtorët e arsimit kanë marr në mënyrë lineare. Si drejtori si punëtori teknik kanë marr 20 marka, s'ke pas qysh mi da, s'ke pas kriterë.

Ma vonë '95-tën janë kriju kriteret, u bo diferencimi në mes të mësuesve, arsimtarëve, drejtorit, pedagogut e tjerë, janë kriju kriteret. Në fillim është finance vetëm arsimit fillor dhe i mesëm. Osht participu universiteti me mjete plotësuse. Se mjetet plotësuse në fakultet i kanë grumbullu përmes studentëve, i kanë pas hartimet studentët kur janë regjistru kanë pagu diçka edhe i kanë kriju mjetet e veta. Kështu që, u dasht me participu prej Këshillit Qendror të Financimit. Për shkak se në fakultet, Fakulteti Ekonomik për shembull ka pas numër studentëve ma të madh, ka kriju të ardhuna ma të mëdha.

Ndërsa Fakulteti i Kulturës Fizike ose Muzika, Arti kanë pas numër të vogël studentëve. S'kanë mujt me siguru as me ndihmu me të ardhuna personale, kështu që është kriju në fond i përgjithshëm në universitet që e ka bo nivelizimin e të ardhunave, që të kenë të ardhura të barabarta. Këto pare këshilli i ka siguru përmes diasporës, diaspora i ka dhonë mjetet plotësuese. Ndërsa këta që s'kanë mujt me i grumbullu në komunë Këshilli Qendror i ka participu. Po osht interesant se për arsim në vitet '90-ta janë shpenzu 205 milion marka, prej 205 milion vetëm 32 për qind janë siguru nga diaspora tjerat 68 për qind janë mledhë në Kosovë.

Njerëzit e kanë bindjen që krejt financimin e arsimit e ka bo diaspora. Nga diaspora u financu vetëm 32 për qind. Këto kanë shku përmes qeverie, qeveria i ka dhonë mjetet plotësuese Këshillit Qendror. Ka qenë vështirë me i bajt mjetet prej qeverie. Qeveria ka qenë në Tiranë, por kanë vepru kësisoji. "Dardania" banka ka qenë e Kosovës dhe ka vepru në Shqipëri. Mjetet plotësuese biznesmenët e Kosovës mjetet i kanë dorëzu në Këshill Qendror, ndërsa mjetet e veta janë shku i kanë marr në bankë atje në Tiranë.

Për shembull këto firmat e mëdha, mos me i mbajt mjetet në mënyrë mekanike sepse ka qenë fshtirë me i mbajt mjetet prej në vendi në një vend. A këtu ka qenë problem shumë aktivistë që kanë majt mledhje prej Prishtinë nëpër komuna tjera janë rrah, janë maltretu dhe ju kanë marr paret ka ndodh në rrugë ju kanë marr paret. Për shembull u dasht me i kamufllu me i shti me molla, me pemë e me perime me i shti paret, me i kamufllu, sepse i kanë marr në autobus i kanë çu 100 rrugë i kanë gjet.

A këto komunat që janë financu ma së shumti prej Këshillit Qendror, komunat që kanë siguru të ardhuna ma të larta, që kanë marr pare ma së pagu nga Këshilli Qendror kanë qenë Gjilani 17 %, krejt tjerat i ka siguru vet. Peja 19% i ka marr nga Këshilli Qendror tjerat i ka plotësu vet. Vitia 22%, Juniku

22%, Prizreni 21% e tjera. Ndërsa mjetet që i ka marr nga Këshilli Qendror i Financimit ma së shumti i ka marr Skenderaji 74% domethonë vetëm 26% ka mujt me i siguru vet. Drenasi 63%, Malisheva 57%, Mitrovica 56%, Fushë Kosova 54%. Tjerat janë qitu në mes, domethonë nuk ka asnjë që ka mujt mu vetfinancu.

Ka raste që kanë dasht me dhonë pare, kanë dhonë pare edhe njerëzit që s'kanë pas, njeni për shembull një prind i ka shit dy lopë edhe paret ka thonë po du me ja nda arsimtarëve, thotë, "I kom pas dy lopë ni loë e shita qeto paret du me ju dhonë arsimtarëve". Ni rast osht interesant, osht rastësisht i fshatit tim Tomoc ni Mustafë Lubeniqi u dal në pension. Pensionin e ka pas 1100 franga ka thonë, "Du me i jep këto pare po mos me ma shenu emrin kërkun hiç". Edhe dashti me mi dhonë mue ato pare, unë thash, "Unë pare s'marr, pa dëftesë nuk i marr paret".

Se kanë qenë dëftesat për ata që kanë dhonë pare, dëftesat me numër serik kanë qenë. Edhe i thash, "Dorëzoj në Istog, thuj 'Po du me i dorëzu pa emën'". Edhe ai i ka dorëzu pa emër veç e ka marr dëftesën, anonim ka marr që i ka dorëzu 1100 franga. Domethonë nga modestia s'ka dasht me përmen emrin, unë në libër ja kom përmend emrin si rast specifik. Ka raste plot, ka raste që ka thonë, "I dho paret po mos ma qit emrin, mos ma shëno emrin fare".

Këta si vishin prej jasht, si kanë mledhë pare në diasporë dojshin me i dorëzu në Këshill Qendror të Financimit janë kon marr vesh me ta që, me gazetën "Bujku" që me i qit emrat se ai s'guxojke me marr fletëdërgesën, fletëpagesën se u dufke në kufi se i nalke policia edhe atëherë jena marr vesh në "Bujk" me qit "Filan-fisteku i dorëzoi në Këshill qekaq" për shembull 1 mijë, 15 mijë marka i ka dorëzu. Qe ai me pas dëshmi me ju tregu njerëzve që i ka dorëzu në Këshill Qendror të Financimit. Unë në Këshill Qendror të Financimit kam punu vetëm tri vjet e gjys mandej, s'kom punu në këshill po kom punu në Ent teksteve mjeteve mësimore në vitin 1997.

Anita Susuri: E në Ent Pedagogjik a na kallxon qysh u kon qajo periudhë?

Bajram Shatri: Jom marr me plan dhe analizë. Kom bo raporte vjetore të regjistrimit të nxënësve në shkolla të mesme, shkolla fillore dhe shkolla të mesme. Raportet kanë qenë 40 dej 50 faqe, raport kom bo. Krejt i kem përfshi shkollat e mesme, shkollat fillore, fakultetet. Se në fakultet kam qenë edhe administrator kam qenë në fakultet. I delegum nga Ministria e Arsimit në senat. Edhe kështu që, i kom marr shënimet, i kom rujt shënimet i kom bo analizat, raportet, raportet në mes shkollave fillore, të mesme, fakultetet, lëvizja e nxanësve, lëvizja e punëtorëve të arsimit. Shkapërderdhja e nxanësve, shkapërderdhja në mes komunave simas shkollave. Komunat e varfëra ekonomikisht kanë pas shkapërderdhje ma të madhe të nxënësve. Se janë dal në diasporë janë shku.

Kështu në qytet s'ka pas, lëvizje ma pak ka pas. Problem ka pas në vitin '98 kur filloj lufta '97 - '98, vendosja e fëmive prej zonave luftarake ku ka shpërthyer lufta në zona ma të sigurta nëpër qytete. Numri i nxanësve nëpër qytete u shtu bukur shumë. Në Prishtinë për shembull ni numër shumë i madh i nxënësve përmi 2 mijë nxanës janë ardh nga zonat e Drenicës ku i ka zonë lufta i kanë pas kushtet e

fshtira. Edhe ekshtu numri i nxanësve pat lëvizje të mëdha në disa vende u rrit numri nxanësve në disa u zvogëlu edhe pat mbyllje të shkollave për shkak në Drenicë për shembull, për shkak të luftës.

Anita Susuri: E në kohën kur kanë fillu bombardimet a keni qenë në punë apo ma herët keni dal '99-tën?

Bajram Shatri: Në punë kam qenë në Ent teksteve, prej '97-tës, prej shtatorit '97-tës jam në Ent Teksteve dhe Mjeteve Mësimore. Enti i teksteve u qujt deri '98-tën, 1 janar '98-tën e kemi ndërru emrin prej Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore, që edhe Beogradi e ka pas janë shëndru në shtëpinë botuese Libri Shkollor, që e ka pas edhe Shipëria shtëpi botuese. Edhe sot e ka emrin shtëpia botuese Libri Shkollor. Në shtëpi botuese kom shku si kryeredaktor kom shku. Dy vjet kom punu si kryeredaktor. Mandej prej '99-tës e deri 2004-tën kam qenë drejtor, 25 vjet kam qenë drejtor i shtëpisë botuese Libri Shkollor.

Anita Susuri: E gjatë luftës a keni qenë në rrezik, a ju kanë përndjekë në Prishtinë?

Bajram Shatri: Në Prishtinë kam qenë gjatë luftës, këtu në Matiqan kam qenë, prej këtu në Kodër Dillit kom shku te Zijadin Gashi kam shku qaty kojshi, se gjoja ma sigurtë atje. Ata ishin ikë prej atyhit ishin shku në diasporë, kanë dal jashtë. Deshta me përmën edhe për tekste edhe në ato kushte tekstet janë botu, tekstet shkollore, janë pajis nxansit me tekste shkollore. Bile '97-tën, '98-tën janë dhanë edhe tekste Qeveria ka çu mjete plotësuese për paisjen e nxanësve varfanjak me tekste shkollore. Ata zakonisht me regjione janë shku, në Mitrovicë për shembull në Mitrovicë janë pajis nxansit me tekste falas, një numër i tyre.

Në të gjitha komunat po Mitrovica kryesore osht veçu. Tekstet janë shtyp edhe janë dal në treg. Dokumentacioni pedagogjik poashtu, dokumentacioni pedagogjik deri në vitin '97 i ka siguru LASH-i dëftesa, diploma, ditarë '97-tën i ka siguru Enti i Teksteve pjesërisht. Edhe tekstet, dokumentacioni pedagogjik edhe tekstet shkollore prej '92-tës janë botu tekste shkollore edhe janë shpërnda nëpër punkte. Ka pas forma të ndryshme të pajisen nxansit me tekste, i kanë marr i kanë grumbullu në shkollë ose prindërit i kanë marr në vende të caktume, nëpër punkte. Ka pas lloje të ndryshme do të thotë të paisen nxansit me tekste shkollore. Por nuk ka aps raste që kanë mungu tekste shkollore.

[Këtu ndërprehet intervista]

Anita Susuri: Faleminderit edhe një herë shumë që keni shpreh gatishmërinë dhe që keni qenë pjesë e kësaj, dhe falemnderit për kontributin!

Bajram Shatri: Kënaqësia ishte e imja.